

Zonjusha Armela Ndokaj gjate periudhes se praktikës ne ndermarrjen Tolaini e Castelnuovo Berardenga eshte ofruar me miresjellje per te perkthyer ne shqip disa kapituj te librit "Appunti per il Vignaiolo Naturale". Kjo do te jete shume e nevojshme per shume ndermarrje vreshtarie te tjera te cilat kan shume personel shqiptare.

HARDHIA

Hardhite si te gjitha organizmat me te larta, jane te organizuara ne sisteme te ndryshme te organeve, secila prej tyre zhvillon nje ose me shume funksione vitale fiziologjike. Nje hardhi esht mire kur te gjitha organet e saj funksionojn siç duhet, fal mekanizmave te kompensimit mes tyre.

Nje hardhi qe eshte e shendetshme eshte me rezistuese ndaj stresit dhe semundjeve, dhe ka nje aftesi me te madhe per te bashkvepruar pozitivisht me mjedisin ne te cilin jeton, duke i trasmetuar frutave nje konotacion territorial te forte.

Hardhija eshte nje bime me aftesi ngjitje. Ky aspekt eshte me pak ose me shume i fuqishem dhe i zjatur ne varesi te tipit te tokës. Ne pergjithsi ka nje shtyrje vegjetative te forte ne pjesen e pare te sezonit, kur temperaturat dhe disponueshmeria e ujit nuk jane te limituara. Nese rritja vegjetative eshte e tepert mund te nxjerre ne pah ndjeshmerine ndaj semundjeve dhe stresit te ujit veror ose zgjatjen e fazes se pjekjes.

Ne raste te ndryshme eshte e nevojshme te miratojme strategji, duke filluar nga menaxhimi i tokës, ne menyre spontane per te drejtuar zhvillimin fillestar me te moderuar.

Energjija e hardhise percaktohet nga dendesia e mbjelljes e jo nga sistemi i pleherimit, dhe kontrollohet ne dimer me krasitjen e jo ne ver me shkurtimin e vegjetacionit.

Zhvillimi i paket nuk do te thote qe hardhija duhet te vuaj per te dhen me te miren e saj: e rendesishme eshte qe te rritet ngadale, pa pershejtim ose per shume kohe (vonesë fenologjike).

Rritja vegjetative duhet te jete e rregullt dhe e balancuar. Cfare do te thot rritje e balancuar ?

Periudhat e favorshme jane te karakterizuara nga nje bilanc pozitiv ndaj disponueshmerise ujit-ushqimit dhe nga nevojat e bimes. Ne kete periudhe munde te kemi dy situata:

- bima iu dorzohet tundimit dhe perdor kalori te teperta per shpejtimin e rritjes = zhvillim i tepert
- mekanizmat e kontrollit (natyrore ose antropogjene) funksionojn dhe pjesa e elementeve ushqyese e pa perdorur eshte mbledhur si substance rezerve

Kjo energji ka rritje nga njeri vit ne tjetrin, behet i rendesishem ne çaste veshtirsie kur disponueshmeria e enegjise esht e ulet.

Ne kete menyre hardhija mund te kete nje rritje me te rregullt gjate sezonit: nese kontrollojm forcen ne fazen e pare te sezonit perballohen me mire streset verore dhe faza e fundit e pjekjes.

Casti i bilancit negativ verifikohet normalisht gjate ciklit sezonal edhe ne mungese te ndryshimeve te ambientit. Ne momentin e çeljes kerkesa e shumet e energjise (per rritjen e degeve dhe mbledhja ne veshin e rrushit) eshte gjithmone e mbeshtetur nga rezervat e

mbledhura tek rrenjet dhe tek trugu. Nese keto çaste perballohen me veshtirsi, ne fazat ne vazhdim do te verifikohet nje ulje e zhvillimit te degeve te bimes..

BALANCIMI

= per bimet eshte kapaciteti per te duruar streset dhe mos pergjigjet e zhvillimit ne bollek (me fenologji dhe me rezultate me konstante).

Ne vreshtari fjala magjike eshte “balancim” = veterregullim me rrenje te thelle . Balancimi esht mireqenje, mireqenja eshte shendet, shenteti esht cilesi. Prodhimet me te mira meren gjithmone nga vreshtat qe duan me pak kujdes sepse hardhijat jane me pak reaktive ndaj streseve.

NATURA E TOKES – OBIEKTIVI ENOLOGJIK – FORMA DHE MADHSIJA E HARDHISE

Per vreshtat ne balancim strategjite agronomike jane:

- dendesia e mbjelljes = largesia ne rresht
- menaxhimi i tokes = perzirje plehrash
- forma e trajnimit dhe krasitjes = pak dege per hardhi, prerje te jashtme

Ne baze te ketyre parimeve masat ndryshojne sipas situates.

Balancimi meret ne nje menyre preçize vreshtarie i bazuar ne dy gjera:

- **Biondryshim** = perdorim biotipesh te ndryshme ne ambiente te ndryshme
- **Veterregullimi** = kontrollimi shprehjes vegjetative-produktive permes konkursit per shkak te mbjelljes dhe te mbulimit te barishteve.

Metoda Bio nuk eshte vetem nje menyre per te ulur impaktin ambiental por eshte mjeti me i pershtatshem per te realizuar nje model vreshtarie enologjik me me shum harmoni me token.

Obiektivi i vreshtarise natyrale esht ulja e perdorimit te inputeve te jashtme duke shmangur nderhyrje te kota, qe jane gjithmone me shume ose me pak te kushtueshme (sidomos nese jane manuale), te pasakta (sidomos nese jane te mekanizuara) dhe te demshme (nese jane kimike). Duke rritur efikasitetin e energjise se brendshme ulet nevoja e energjise se jashtme dhe garantohet efekti i perfitimeve vit mbas viti.

VETERREGULLIMI I VRESHTIT

Veterregullimi i vreshtit duhet udhehequr me nje planifikim te kujdesshem dhe me nje menaxhim te perpikte ne fazen e rritjes. Ne vitet e ardhshme praktikat kulturore duhet te reduktohen ne minimumin e nevojshem.

Ne cdo kompani dhe ne cdo sezon egzistojne dy nivele nderhyrje: te zakonshme dhe te pa zakonshme. Te thjeshtesosh punen e zakonshme te lejon te kesh me shume kohe per te bere me me shume shpejtesi punen e pa zakonshme.

Te perqendrosh punen tek mjetet parandaluese do te thote te perqendrohesh me par tek shkaqet (toka) dhe me pas tek efektet (vegjetacioni).

Komponenti i rasti fatal ne lidhje me klimen perfshin nje faktor te rrezikshem dhe te pashmangshem qe duhet te kompensohet nga nje vresht ne gjendje te toleroje pasojat e sezoneve te rasti (toka me te shendetshme dhe me te strukturuara, hardhija me te balancuara dhe me pak te prekshme). Sidomos duhet shmangur mbledhja e streseve ne vitet e ardhshme (qe do paksonte ne pak koh potencialin produktiv): pas nje viti te veshtire eshte mire te paramendosh disa nderhyrje te jashtzakonshme.

KRASITJA

- duhet per te ndertuar dhe per te ruajtur nder vite nje forme dhe nje madhsi te hardhise ne menyre qe te garantoj prodhomin dhe krasitjen e ardhshme
- por munde te jete (dhe shpesh eshte) shkaku kryesor i shkaterrimit te hardhija pas tharjes se drurit nga shkurtimet e bera

Ne krasitje duhen miratuar strategji dhe procedura operative te dizajnuara per te shmangur berjen e shkurtimeve te medha dhe lenjen e plageve te perhershme se bashku me rrjedhjen e lufes.

- Gjate fazes se rritjes = sigurohuni qe gjithmone te zgjidhni deget me te uleta ne menyre qe te prerat te mbeten jasht qarkullimit limfatike.
- Gjate krasitjes se prodhimit = gunjo pa sy, ne forme peme ose nje dege pa prerje te theksuara dhe\ose kthim dege.

CILESIA DHE CMIMET

Te ardhurat e kompanise jepen nga gjendja e shitjes produktit e bazuar ne ate qe kushtonte. Objektivat e vreshtarise moderne jane rritja e sasise dhe ulja e cmimit. Ne pergjithsi besohet qe dy gjerat nuk mund te bashkejetojne.

- Duke rritur cilesine mund te rriten edhe cmimet
- Duke reduktuar cmimet mund te reduktohet dhe cilesia

Faktoret vendimtare jane shpejtesia dhe kohezgjatja e rritjes vegjetative. Ne hardhi bashkejetojne dy tensione te medha: nevoja per te mbijetuar dhe per tu riprodhuar. Organizmat vegjetal ndjekin keto dy objektive sipas aktivitetit vegjetativ (prodhim energjie) dhe aktivitetit produktiv (pjekja e frutave). E para duhet te jet ne sherbim te se dytes. Ne bimet e balancuara ky proces ndodh vetvetiu.

ZHVILLIMI I NGADALET

Me bime te pa zhvilluara mire mund te bejme:

- Me shum cilesi (me pak afastelament)
- Me shum tipe (me pak input)
- Me shum te ardhura (me pak ndrehyrje)
- Me shum jetgjatesi (me pak strese)
- Me shum bio (me pak ndjeshmeri)

CILESIA DHE CMIMI

REDUKTIMI KOSTOVE TE PRODHIMIT

REDUKTIM I PUNES
= MJETE MEKANIKE



CILESIA ULET

REDUKTIM I FORCES
= VETERREGULLIM VETVETIU



CILESIA RRETET

**TE TRASFORMOSH HARDHIN NGA BIME NGJITESE NE BIME MBLEDHESE
ESHTE VETEMBROJTJE**

NUK ESHTE NE RREZIK POR ESHTE E MBROJTUR NGA MJEDISI SAJ

Nese mundohemi te ulim cmimet me kimiken dhe me mekanizimin rrezikojme te perkeqesojme cilesine dhe jetgjatesine e vreshtit. Per te reduktuar cmimet duhet te:

- Reduktojm forcen (per te ulur nevojen e nderhyrjes)
- Sa me shpejt te jet e mundur (per te rritur efikasitetin dhe shpejtesine e operimit)
- Organizim i mire (per te ulur shpenzime kohe dhe energji)

Reduktimi forces, shpejtesia dhe organizimi jane te domosdoshme per te permirsuar cilesine duke siguruar keshtu nje vreshtari te mire bio, dy objektivat (cilesia dhe kursimi) jane koerente dhe bashke-egzistuese.

Nje menaxhim i mire ul cmimet e prodhimit dhe zgjat kohezgjatjen e mbjelljes duke i garantuar funksionalitetin dhe perfitim ne periudha kritike.

Vreshtaria per te qene e qendrueshme duhet te kerkoje zgjidhje konkrete te tipit 'cfare duhej bere' ne te kaluaren (kur ne vresht u mernin vendimet pa degjuar presione te jashme) dhe 'si duhet bere' ne te ardhmen (fal shume njohurive per te zhvilluar teknika bioagronomike te besueshme dhe ekonomike).

PROBLEMET ME TE MEDHA TE VRESHTARISE

- Force e tepruar (cikli me i gjate eshte me i ndjeshem ndaj te kunderve)
- Ndryshmeria bimeve (menaxhim me pak preciz dhe ne fuqi)

Shkaqet:

- Shkaterrime te dukshme = shkaterrim i profilit natyral, prishje e qendrimit hidrologjik natyror, varferim i fraksionit mikrobiologjike...
- Rrjeshtat teper te gjere (per traktora te medhenj dhe te rend) = me shum largesi per cdo hardhi = me shum shendet (force) qe jo gjithmone eshte e arritshme nga te gjitha bimet (ndryshmeri)
- Zgjedhje klonale = erozioni gjenetik (vera te njellojta), me pak biondryshime ne vresht (me shum rrezik shendeti)
- Klone te seleksionuara me objektive enologjike sasiore = difuzion internacional i kultivimit, klone me vesha me te medhenj, me shum sensibilitet ndaj semundjeve dhe veshtiresi per pjekjen...
- Krasitje teper te pasura = penalizojne cilesine e rrushit dhe jetgjatesine e hardhise
- Perpunime te shumta te tokes = me shume rritje dhe parregullsi ne zhvillim, shkaterrim me substanca organike te tokes, me shume varesi ndaj plehrave dhe pesticideve...

- Hedhje plehu te pa balancuara = per te mbeshtetur rritjen e tepert, te percaktuara pa njohje te thella ndaj tokes dhe pa dallime te qarta nga vendi ne vend
- Ujitje te pa justifikuara = per te promovuar nje rritje dhe nje prodhim te ekzagjeruar ose per te kultivuar hardhin ne ambiente te pa pershtatshme
- Menaxhim i paarsyshem i bimes = nderhyrje te pa nevojshme dhe jo koerente te krasitjes se gjelbert
- Lufta ndaj kalendarit = shum besim ne kimiken dhe pak disponueshmeri per te dal neper vresht
- Perdorimi i diserbesh kimike – shkretetirizim i tokes
- Zgjedhje vjelje te paarsyeshme = te thena nga presione jo agronomike

Te gjitha keto forcime shkaktojne me shume ndjeshmeri ndaj streseve, me pak cilesi te prodhimit dhe kosto me te larta.

RRITJA DHE CILESIA

Egzistojne mjete agronomike qe ndihmojne token ndersa disa te tjera qe e shkaktojne. Kushti domosdoshem eshte rritja e paket.

Nuk eshte bere asnjehere nje vere e mire me hardhi teper te rritura dhe nuk eshte e mundur te ulesh cmimin me hardhi te babezitura.

RRITJA

- Varet nga forca e hardhise qe ne baze te numrit te syve, eshte e ndare ne mes te cdo dege te pranishme, ne te cilin forca eshte anasjelltas proporcionale me numrin dhe eshte e ndikuar nga pozita e tyre

PJELLORI

- Eshte nje karakteristike qe i takon cdo syu = ndryshon sipas pozites se hardhise por nuk eshte subjekt i numrit te syve te hardhise

PRODHIMI

- Sasia potenciale e prodhimit varet nga numri dhe nga pozita e syve per cdo cep dhe nga rritja (kapaciteti i hardhise per te mbeshtetur zhvillimin dhe pjekjen te nje numri me te madh ose me te vogel veshash) = me te njejtin gjenotip, sa me e madhe te jete rritja aq me te medhenj do te jene veshat

CILESIA

- Nuk varet nga pak prodhimi i cdo veshi por nga rritja paket = ndalim i hershem i rritjes vegjetative i ndjekur nga nje periudh e gjate mbledhje, ne baze te raportit gjethe\vesha te hardhise (deget me rritje te ndryshme kane dinamika pjekje te ndrydhme edhe tek vete hardhija)

BALANCIMI

- Ne hardhi = ekuiliber ndaj strukturave gjithevjetore dhe ndaj strukturave vjetore (trungu-rrenja\deget)
- Niveli cdo dege = ekuiliber midis organeve vjetore (gjethe\veshe)

CILESIA DHE TIPICITETI

- Rritja e paket = shkaku
- Prodhimi i paket = efekti

Ne nje vresht eshte shume e veshtire te kesh te gjitha hardhit me te njejten rritje. Eshte sigurisht me e thjeshte te keshe me shume homogjinitet ne cdo dege vetem duke ndryshuar numrin e degeve per cdo hardhi sipas rritjes se tyre:

- Vetem keshtu sdo te kete dege me te dobeta dhe dege me te forta tek te cilat rrushi nuk munde te pjeket mire.

Veshat e rrushit jane te ushqyer nga gjethet e degeve ne te cilat ndodhen: madhesija e veshit varet nga forca e vete deges.

- dege jo shume te rritura = vesha me te vegjel dhe me te ralle = me shume harmoni e pjekurise = me shum cilesi dhe me pak nevoje per ti rralluar
- dege te rritura = vesha me te medhenj dhe me te ngjeshur = me pak harmoni e pjekurise = me pak cilesi dhe gjithmone nevoje per rrallim



Madhsija e kokrrave te rrushit dhe e veshit varet nga rritja e vete deges.



Nese dega nuk ka gjethe te mjaftueshme veshi nuk mund te piqet.

FORMA DHE MADHSIJA E HARDHISE

- Shprehin raportin e fuqi\peshe
- Vendosin shperndarjen e energjise ndaj organeve te bimes
- Percaktojn konsumet dhe graden e autonomise (rezistence ndaj streseve)
- Ndikojne shume tek cmimet e menaxhimit dhe ne qendrimin bio
- Percaktojne potencialin per sasin dhe cilesin e prodhimit

- Hardhijat me te vogla zakonisht prodhojne me pak por kane me shume cilesi, kane me shume rrenje, cikli eshte me i shkurter, mbledhin me shume riserva, jane me jetgjatese dhe me rezistuse.
- Hardhijat qe nuk jane shume te rritura = kane me pak kerkesa dhe me pak varesi

HARDHI MBLEDHESE

- Energjite e hardhise shkojne sidomos drejt trungut dhe rrenjeve = me shume veterregullim, vetemrojtje dhe mbledhje.

HARDHI TE RRITURA

- Energjite e hardhise shkojne sidomos drejt gjetheve dhe degeve = me shume energji, sensibilitet dhe jo homogjinitet.



Hardhijat teper te rritura jane me te ndjeshme ndaj patogjeneve.

Hardhijat teper te dobeta jane me te ndjeshme ndaj streseve.

Ne te dyja rastet rriten cmimet dhe ulet cilesia.

VRESHT TEPER I RRRITUR

- Klime i favorshem ndaj semundjeve
- Nje hardhi shume e rritur harxhon shume dhe prodhon keq

VRESHT TEPER I DOBET

- Pak kapacitet vetembrojtje dhe shume ndjjeshmeri ndaj fatkeqesive
- Nje hardhi teper e dobet prodhon pak ose asgje dhe ka nevojte per shume kujdes (inpute)

HARDHIJA IDEALE

- Shume rrenje (me shume thithje)
- Rrenje te thella (me shume vete-efikasitet dhe stabilitet)
- Dru shume I vjeter (me shume riserva)
- Shtresa e gjethit e ndricuar mire (e hapur, me pak shtresa)
- Pak dege (te gjitha njelloj)
- Gjethe te vogla (me shume efikacitet fotosintetik)
- Prodhim me shume vesha te vegjel dhe te rralle


MBJELLJA MANUALE E FIDANIT ME RRENJE TE SHKURTER

- Me nje organizim te mire munde te jete nje zgjidhje e mire edhe per siperfaqe te medha

- Gjithmone rezultate te mira edhe me para kohes normale qe duhet te nis te lulezoje.
- I paraprire nga germime te thella (ne janar-shkurt) = eshte zgjidhja me e mire per te favorizuar zhvillimin e rrenjeve vertikale
- Lejon me shume sakesi dhe precizion.

Verja e shtyllave munde te ket shume avantazhe:

- Rregull ne vresht = ne vreshtin qe eshte ne prodhim mekanizimi do te jet me i lehte (me shume efikasitet operativ dhe me pak rrezik per te demtuar hardhine)
- Me verjen e shtyllave shmangen demtimet ndaj hardhijave
- Mbas mbjelljes se hardhive, toka nuk duhet te shkelet direkt per verjen e shtyllave



Mbjellja me rrenje te shkurtra jep rezultate me te mira por duhet te mbjellen me heret dhe ne meyre me siperfaqesore: rrenjet duhet te kene me shume kohe dhe vend per te filluar rritjen e tyre para se te celin gjethet.

Kur mbjellja behet ne kondicione te mira zhivillimi eshte me i rregullt.

Ne nje dimer me klime normale (me renje shiu te mjaftueshme) mundesia e nje mbjellje te shpejte nuk eshte e mundur, kshu qe shtyhet mbjellja ne pranvere (eshte me e lehte te besh nderhyrje). Ne mbjelljet me vonese (pervec faktit qe duhet ujitur toka direkt mbas mbjelljes) do kemi me pak zhvillim dhe me shume zona te pazhvilluara (me shume probleme homogjiniteti dhe zhvillime te vreshtit)

Pasi te jete mbaruar venja e shtyllave duhet te behet nje punim i siperfaqes toksore per te eliminuare shkeljet e bera (perndryshe toka behet teper e forte dhe smund te kete me shnderrime te lendeve te lengshme dhe te gazta me atmosferen = rrenjet vuajne nga lageshtira e tepert ose nga e thatesia).

KOHA E MBJELLJES

Sido qe te behet mbjellja, faktori me i rendeshishem eshte lageshtira e tokes. Shkaku i pare i vuajtjes shpesh here eshte uji.

- Mbjellja e fidaneve (eshte shume i rendesishem zhvillimi fidanit i cili duhet te ndihmohet nga vadtja direkt pas mbjelljes)
- Fidanet duhet te rrijne ne uje per 24 ose 72 ore ne varesi te temperaturave te jashtme dhe nga kohezjatja e renjes shirave.
- Per te punuare ne periudhen me te mire duhet te pregatitet toka ne menyre perfundimtare ne dimrin e meparshem dhe duhen mbajtur fidanet ne ambiente te ftohta si ne frigorifer deri ne momentin e favorshem.

THELESIA E MBJELLJES

- Nuk duhet te jete e tepert (rrenjet duhet te ndjejne token)
- Te mbjellesh 'lart' do te thote te vejsh rrenjet ne shtresen me te mire te tokes.
- Varet nga cilesia e tokes:
 - 1) Toka argjilore (me balte) = zhvillimi i rrenjeve munde te ngadalsohet nga temperaturat teper te larta = mbjellje me siperfaqesore (ne menyre te tille qe rrenjet te jene ne zonen me te ngrohte)
 - 2) Toka me rere dhe me gure = rreziku eshte disponushmeria e paket e ujit = mbjellje me e thelle (ne menyre te tille qe rrenjet te jene ne zonen me te fresket)





MATERIALET E MBJELLJES

Ne te kaluaren shtyllat i venin mbas dy ose tre vitesh (per mos kryerjen e shpenzimeve direkt dhe per te zgjatur kohezgjatjen). Pervec kontributit, eshte me mire te perfundosh stukturen mbajttese (shtylla, tela...) per te thjeshtesuar rritjen e hardhive dhe menaxhimin e kultivimit.

Meqe cmimet e punes me dore per mirembajtjen jane me te medha se ata te bjerjes, materialet duhen zgjedhur me cilesi te mire pavaresisht se ne fillim munde te duket se kushtojne shume:

- Duhet shmangur shpenzime te kota per paisje te teperta qe i krijojne probleme mirembajtjes dhe mekanizimit
- Struktura duhet te jete e thjeshte dhe e matur duke u bazuar tek funksionaliteti dhe kohezgjatja.
- Materialet duhet tju pergjigjen kerkesave te madhsise dhe te rezistences ndaj erozioneve dhe stresit.

Numerimi i shtyllave eshte shume i rendesishem per te menaxhuar me mire vreshtin.

SHTYLLA DRURI

Duke perjashtuar (bakrin, kronin dhe arsenikun..) qe kerkojne nje dispozicion te diferenciuar me pagese, me i miri eshte druri i geshtenjes per me shume jetgjatesi, nga menyra sesi eshte shkurtuar dhe nga mirembajtja:

- Me shume rezistence me fibrat vjetore te ngushta (rrathe) = kur rriten ngadale ne toka te varfera dhe me drenazh (ne toka si male ose lendina)
- Shkurtimi i pemes duhet bere ne forme gjysem hene (ne shkurt sipas te vjeterve) dhe stazhonimi duhet bere jashte per 6 muaj.

Vleresimi i shtylles para blerjes = ngrohtesi dhe fortësi për të vlerësuar origjinën dhe stazhonimin.

Shtyllat e drurit i rezistojnë mirë presjoneve dhe sforcimeve, nëse kanë një origjinë të mirë dhe për stazhonimin nuk duhet djegia e majes. Shtylla e drurit nuk duhet të birohet (si përshembull për të fiksuar telat)


SHTYLLA METALI

- Avantazhet = janë ekonomike, janë kohezgjatëse, të thjeshta për tu transportuar, të thjeshta për të vënë telat
- Për të reduktuar impaktin vizivë mundë të lyhen me ngjyra natyrore
- Janë produkte industriale por po shpërndahen edhe tek produktet bio

Verja e shtyllave të drurit është me koherente me bio'n, të prodhuara në kompani (garantojnë me shumë kohë pune për punësit) ose të blera nga jashtë (duke mbështetur sektorin agronomik pyllor).

VEND ANKORIMI I TELAVE

Egzistojnë zgjidhje të ndryshme edhe për telat e gjata, duhet një strukturë e thjeshtë dhe shumë rezistuese = shtyllë 45° e kthyer me një tirantë, vertikale ndaj kokës së shtylles nga tela e zingates (e sapo dalur nga toka, 80 cm nga baza e shtylles dhe e lidhure me një pllakë betoni që është e gruposur 1 metër).



Nëse shtylla është tepër e drejtë duhet të terhiqet nga brenda drejt rreshtit. Nëse tiranta është shumë afër kokës së shtylles nuk mundë të japë një mbajtje të fortë dhe nga presioni i tepërt del vend ankorimi.

KUJDESTARET

- Me mirë me dru të stazhonuar dhe goxha të madhe (për me shumë kohezgjatje dhe rezistencë ndaj presionit të tastatës), por janë gjithmone më të vështira për tu gjetur.

- Cana bambù'je = nuk zgjasin shume, jo per gunjo dhe vitin e 4 nuk kan me nevoj per kujdes sepse deget lidhen direkt tek telat
- Tutore metali = cmim qe ndryshon por qe shpesh here eshte i larte , te rrezikshem ndaj nxehtesise se elektricitetit, ndryshken dhe munde te ndryshkin edhe telate.

TELAT


Zgjedhja duhet bere ne baze te jetgjatesise:

- Me celik = kushtojne me shume dhe jane shume te holla (mundet dhe te presin vegjetacionin)
- Me plastike (munde te ndodhi qe munde te priten dhe nuk jane bio)
- Normalisht zgjidhen tela hekuri

Thjeshtesia e puneve me dore ne gjelberim eshte shume e rendesishme (per te permirsuar mikroklimen dhe per te mbajtur kokrrat e rrushit me te ralla) = afatet kohore varen nga dispozicioni telave.

TELAT E STIVOSURA = te pozicionuara ne menyre alternante nga majtas djathtas shtylles.

- Deget nuk levizin dhe mbajne distancen e duhur nga veshat e rrushit
- Duke pasure me shume pika mbajttese – e menjehershme dhe operative - eshte me i shpejte
- Ne shtyllat e drurit: 4 ose 5 tela fikse te disponume ne menyre te stivosur
- Ne shtyllat e metalit: 2 ose 3 tela fikse te disponume ne menyre te stivosur



FAZA E ZHVILLIMIT

- E rendesishme per zhvillimin dhe menaxhimin e ardhshem
- Gjithmone me e ngarkume sesa parashikohet, nuk duhet nenvleresuar asnje aspekt.
- Duhet te nenvizohen pikat kritike ku duhet ndryshuar puna



Gjate fazes se rritjes dallohet se si do jete hardhija kur te rritet:

- Fidani qe eshte me shume ose me pak i rritur ose i dobet, kur te rritet do te jete gjithashtu me pak ose me shume i dobet
- Duhet shmangur sforcimet, ujitje te teperta dhe pleherim = me shume forma te ndryshme (jo te gjitha hardhijat arrijne te mbajne te njejtin ritëm rritje), me shume rritje (hardhijat kane aparate vaskolare me te medha kshu qe kan nevoja te shumta)
- Qe nga vitet e para hardhijat jane ne grade te shprehin nje nivel te mire shendetit, kane me shume kapacitet tolerimi dhe vetembrojtje, ndersa shprehjet e para te mos mireqenjes munde ta sjellin hardhine ne thatesi te parakohshme.

RASTE TE SHPESHTA MOSMIREQENJE (zhvillim i rrenjeve dhe i degeve te vogla por jo ne harmoni)

- Mbjellje te parakohshme kur ka reshje shiu te shumta dhe temperatura te uleta (mungese oksigjeni) dhe kur ka thatesire ne toka te lira (mungese uji) = rrenjet zhvillohen pak ose keq, gjethet e sapo celura thahen, simptomat e para jane: epinastia (kthim i gjethëve ne renie), nyje te brendshme zig-zag, tharje e kulmit ne dredhe dhe nxirje e cepave.
- Mbjellje te vona ne vitet e nxehta = rrenjet zhvillohen mire por cepat nuk hapen nga vapa e tepert qe i heq ujin (sipas shartimit dhe tipit te parafines).

FAZA E ZHVILLIMIT

Objektivat fiziologjike qe duhen arritur:

- Viti 1° = atekimenti = natyra e tokes (sidomos karakteristikat fizike)
- Viti 2° ose i 3° = zhvillimi = krasitja thate dhe e gjelbert (formimi struktures perhershme)
- Vitet ne vazhdim = balancimi = shkurtimet (kontroll i shendetit dhe i prodhimit)

KUJDESI KULTURORE

Kujdesite kulturore pas mbjelljes duhet te jene te menjehershme:

- Ujitje emergjente (sidomos ne mbjelljet e vona ne tokat e lira)
- Kontroll i barishteve (sidomos ne mbjelljet e parakohshme ne tokat e fresketa)
- Perpunim siperfaqesor (ne funksjon me natyren e tokes)
- Menaxhim i gjelberimit (ne lidhje me shpejtesine e zhvillimit)
- Mbrojtje (nga kerpurdha, insekte, marimanga dhe lepuj...)
- Monitorazh (mungesa ushqyese dhe semundje sistematike)

Krasitja e gjelbert duhet te jete shume e sakte ne menyre te tille qe ne krasitjen e thate te shmangim plage te medha qe pergojne qarkullimin e linfes.

Krasitja thate duhet bere sa me vone (ne mes ose ne fund te marsit sipas kohes se gjelberimit) per te shmangur demtime nga koha e ftohet ndaj hardhijave te reja (jane me te ndjeshme sepse jane me te vogla dhe me te shkurtra).

Nga mungesa e nderhyrjeve ne vitet e para (ne baze te zonave ose te hardhijave) deformimet e zhvillimit jane gjithmone e me shume dhe do te jene nje problem goxha i madhe ne vitet e ardhshme.

MENAXHIM I TOKES

Zakonishte ne dy vitet e para behen punime siperfaqesore per te:

- Shmangur barishtet
- Shmangur formimin e carjeve nga mungesa e ujit ne siperfaqe
- Mirembajtur nje strukture te bute te tokes ne menyre te tille qe rrenjet te jene te lira
- Inkurajuar ngjitjen e ujit per kapilaritet ne favor te rrenjeve qe nuk jane akoma ne thellesi
- Nxitur nje zhvillim te mire vegjetativ

Sipas kondicjoneve (natyra e tokes dhe koha) nderhyrjet siperfaqesore munde te behen me rrip, estirpatori a molle, erpici a denti...

Nese toka eshte punuare shume shpesh dhe eshte shume e holle ose e lagur, pjesa siperfaqesore do te thahet ndersa shtresa e poshtme do te mbetet e lagur = hardhijat e vogla do te vuajne.

Eshte gjithmone mire nderhyrja her ne nje rresht dhe her ne tjetrin per te:

- Shperndare me mire ujin
- Garantuar nje mbajtje konstante te vreshtit



Ne tokat e pjerreta dhe me balte duhet parapritur presenca barishteve. Ne cdo rast, para se te behet inerbimenti (parcial ose i momentit) eshte mire te rigjenerohet toka pas shkaterrimit.

Perpunimi mekanik ne rresht gjate viteve te para duhet te jete parapritur ose vonuar ne baze te lulezimit per te shmangur demtimin e degeve me mjetet e punes (me kontakt direkt ose me levizjen e trungut). Rreshtat duhet te jene mjaft larg nga njeri tjetri per te parpritur hyrjen e inerbimenteve.

Ne fund te sezonit = punimi duhet te jete i thelle ne fillim te rreshtit para se te fillojne reshjet e shiut dimerore:

- Per te rritur kapacitetin e pushtimit
- Per te zjatur perfitimet e shkaterrimit
- Per te pregatitur nje mbjellje te mundshme te nje kulture

Ne te gjitha rastet eshte gjithmone mire nderhyrja ne nje rresht po dhe ne nje rresht jo.

'Pacciamatura' = per te favorizuar ngrohjen e tokes dhe per te shmangur rritjen e farave te keqija, por nuk eshte keshillueshme sepse:

- Ka kosto shume te larte

- Thyrje te lehta me fillimin e rreshtit
- Shperndarje e mbetjeve ne fushe
- Ndalon hyrjen e shiut nga nxehtesija, pengon pleherimin dhe vaditjen

PLEHERIMI

Ne vitet e para aparati rrenjes eshte akoma i pazhvilluar dhe trangu nuk ka mbledhur akoma mjaft rezerva, rrenjet duhen nxitur qe te veshgojne vendin dhe duhet favorizuar trashesia e drurit:

- Faktoret percaktues jane struktura e tokes dhe disponueshmeria e fosforit organik

Ne vitet e para pas mbjelljes duhet shperndare nje bollek doze plehrash vegjetale te veteprodhuara te domosdoshme per te rigjalleruar token mbas shkaterrimit.

Ne zonat e dobeta cdo shperndarje fosfori duhet bere:

- Ne fund te dimrit (ne vjesht eshte e kote sepse nuk eshte akoma e mundur mbledhja e rezervave meqe madhsija e trungut eshte e limituar)
- Pak a shume afer rrenjeve (sipas perhapjes jo afer cepave)
- Direkt duhet groposur (per te favorizuar proceset biologjike)
- Ne disa raste eshte e kote te nderhysh gjate sezonit me bio-aktivizues gjethesh per te mirembajtur nje aktivitet fotosintetik ne periudhat me te ngrohta dhe me te thata per te nxituar thellimin e rrenjeve.

MBROJTJA

Krahasuar me hardhite e rritura, ne vitet e para rritja e gjetheve dhe ndjeshmeria e tyre ndaj semundjeve zgjat zakonisht me shume. Alarmi per mbrojtje duhet mbajtur edhe ne fund te sezonit per te parandaluar:

- Renjen e gjetheve (sidomos ne castin e celjes)
- Rritjen e semundjeve ne vitet e ardhshme.

Problemet shendetesore te materialeve ne shumim jane rritur ne keto vitet e fundit = suksesi ne luften ndaj semundjeve sistematike varet nga kapaciteti per te kufizuar infeksionet dhe nga numri i kontrolleve ne fushe, dhe nga eliminimi menjehershem i hardhive te infektuara. Potencialet e suksesit varen nga mundesia per te perballuar problemin ne pergjithsi, jo ne cdo rresht rrushi.

ZEVENDESIMI NE ZONAT E DOBETA

Pasurimi dhe zhvillimi i nje hardhie ne nje vresht te rritur nuk eshte e thjeshte. Konkurimi me rrenjet e hardhive te zhvilluara eshte gjithmone shume e

thjeshte dhe eshte pak a shume me e veshtire te garantosh menjehershmerine e sherimit. Shpesh here shpenzohet me shume sesa perfitohet.

Mundesia e suksesit eshte me e madhe ne vitet e para dhe ulet ne menyre progresive me vjetersine e vreshtit. Rezultatet varen nga:

- 1) Koha e mbjelljes – sa me shpejt te jete e mundshme – rrenjet kane me shume kohe per tu zhvilluar para celjes, me pak nevoje per uje por me shume angazhim ne kontrollin e fares se keqe
- 2) Menyra e mbjelljes – duhet bere nje grope e thelle 40\50 cm, duhet mbushur me te njejten toke, duhet mbjellur fidani me rrenje te shkurter me 25 cm thellesi, rrenjet do te gjejne toke te bute posht tyre dhe do te zhvillohen vertikalisht
- 3) Kurimet e bera – menjehere kur te jete nevoja (prashitje, vadtje dhe pleherim)

Nese mbushim me dhe gropen e sapo bere, mund ta pregatisim para kohe (ne fund te veres) ne menyre te tille qe qe shiu dhe ngrica te veprojne pozitivisht (neqoftese gropa lihet e hapur, ne momentin e mbjelljes rrezikojme te gjejme token brenda gropes teper te lagur ose teper te thate).

Duke pregatitur gropat ne kohe munde te dime ne kohe numrin e sakte te hardhive per tu zevendesuar. Ne disa raste te rralla konvenon te pregatisesh gropen vetem ne momentin e mbjelljes.

Ne rast te bimeve te demtuara qe jane afer njera tjetres, gropa mund te behet si nje llogara, e hapur dhe e mbyllur me nje skavator te vogel.

Ne vitet e para shartimet e perzgjedhura per zevendesimin e bimeve te demtuara duhet te jene mbjellur ne te njejtatat burime. Zgjedhja e shartimit (ne merite te ndikimit tek cilesia e rrushit) varet edhe nga sasia e hardhive te vogla per tu zevendesuar. Nese numri nuk eshte i larte munde te zgjidhen shartimet me te mira (qe prap se prap nuk do jene te rritura sa hardhijat qe jane prezente). Ndersa kur hardhite e demtuara jane shume, shartimet ndikojne shume me shume tek prodhimi i tere, keshtu qe duhet zgjedhur ne baze te objektivave enologjike (pavaresisht nga shpejtesia e sherimit).

Ne kushte me te veshtira (toka teper te pjerreta, vite te thata, nderhyrje te teperta gjate sezoneve, zevendesim ne vreshta te rritur, ujitje te paketa...) mund te mbjellim shartimet ne fushe (vitin e njejte ose vitin e ardhshem) =

- Me shume rezistence ndaj thatesires
- Zhvillim me i shpejte
- Me pak nevoje per mbrojtje

Ne kto raste angazhimi eshte me i madhe: per ti bere shartimet cdo vit pa u varur nga persona te jashem duhet te mesosh te besh shartimin dhe duhet pregatitur nje vend ne kompani per ti mbajtur ato.

SHELTERS (tuba per mbrojtjen e fidanit) = rezultatet varen nga ngjyra qe ndricon syte e hardhise. Zakonishte ka me shume probleme sesa avantazhe.

- PRO:

- ka me shume zhvillim dhe seleksjonohet dega kryesore
- shihen mire nga larg

- KUNDRA:

- Me shume nxehtesi dhe tharje e degeve
- Ne zonat me te ngrohta duhen hequr ne fillim te majit
- Mund te gjeihen mbetje te tyre ne vresht (qe duhen mbledhur)
- Mbushen me barishte

Gjithsesi kto plastika nuk jane te keshillueshme te mbahen ne vitin e dyt sepse pengojne krasitjen dhe shkaktojne formimin e degeve teper te gjata.

FORMIM I STRUKTURES PERFUNDIMTARE

- Te balancosh zhvillimin siper tokes me ate te rrenjes
- Te favorizosh uniformitetin e vreshtit
- Duhet te formohet nje trung i drejt pa shenja




Nxirje e drurit per shkak te prerjeve te theksuara ose te bera ne periudha te ftohta.

KRASITJA E GJELBERT NE VITIN E PARE

Eshte e domosdoshme edhe pse ndonjehere lehet pas dore:

- Duhet lene dy sy per hardhi mjaft larg njeri tjetrit
- Duhet shmangur zhvillimi i syve afer shartimit
- Duhet prere degat qe jane poshte deges se perzgjedhur per te formuar trungun
- Zgjedhjet per prerjet qe duhen bere duhet te zgjidhen ne baze te madhesise dhe pozicjonit per te shmangur sa me shume demtime duke bere prerje te jashtme qe mos te pengojne qarkullimin e linfes



Nese ne vitin e pare nuk presim degat ne gjelberim qe celin afer pikes shartimit duhet ti presim kur te thahen duke bere prerje me te medha dhe shume te demshme per qarkullimin e linfes.

Tek fotoja dallohet qarte qe fidani eshte mbjellur teper thelle dhe qe toka per rreth eshte shume e forte. Ne kete fidan dallohet qe sdo te kete balancim mes rrenjeve (qe po zhvillohen me veshtirsi) dhe degeve (qe jane goxha te zhvilluara).

KRASITJA E THATE NE VITIN E DYTE

- Lehen dy sy: jo i pari dhe i dyti (sepse jane afer njeri tjetrit dhe vitin e ardhshem te detyrojne ti besh nje prerje te theksuar syrit te perzgjedhur) por i dyti dhe i treti = krasitje me 3 sy tek dega me e ulet, me e zhvilluar ose ne pozicjon me te mire.
- Syu me i ulet duhet hequr direkt ose ne gjelberim



- 1) Nese ne vitin e dyte krasisim me 2 sy, degat do te jene me afer njera tjetres dhe prerja ne vitin e ardhshem do te lej nje shenje te theksuar ngjit me degen e zgjedhur per te formuar trungun .
- 2) Nese krasisim me 3 sy, deget do te jen mjaft larg njera tjetres dhe prerja nuk do te lej shejne trungun e hardhise.

KRASITJA GJELBERT NE VITIN E DYTE

- Zgjedhja degeve (me 10-15 cm zhvillim) = duke prere te gjitha deget qe jane posht deges se perzgjedhur per trungun
- Lehen dy dege mjaft larg njera tjetres ne menyre te tille qe ne krasitjen e ardhshme te kemi vetem nje prerje te jashtme larg pasazhit te linfes
- Me dy dege per hardhi kemi nje aktivitet vegjetativ te mire per shume kohe = zgjatje e rrenjeve gjat sezonit me zhvillim ne thellesi
- Verja e plastikave per fidanet duhet te jete e menjehershme per te favorizuar rritjen e degeve dhe thellesine e rrenjeve
- Prodhimi cilesor/sasior nuk eshte asnjehere interesant = dy vitet e para eshte mire te presesh te gjitha veshat e rrushit ne menyre te tille qe sheqeri i hardhise te mbledhet si rezerve tek rrenjet



Nese nuk zgjedhim mire degen qe duhet bere trung (e cila duhet te jete me e uleta) ne vitin e dyte ose te trete munde te kemi shenja te medha dhe te perhershme.

KRASITJA THATE NE VITIN E TRETE


Ne fillim te vitit te trete kemi 2 dege te gjata: GUNJO:

- Nese dega me e ulet eshte e zhvilluar mire e krasitim per ta bere dege per fruta (dega dominuese per mbledhjen e ushqimit, eshte me afer rrenjes dhe lengezohet perpara = tek hardhija mbetet vetem nje prerje e jashtme qe nuk eshte shume e prekshme ndaj semundjeve).
- Nese deget nuk jane te zhvilluara mire do te formohet vetem trungu duke prere degen me te ulet, qe eshte ne pozicjon te mire rreth 30 cm nga teli.
- Nese te dyja deget nuk jane te zhvilluara atehere krasiten dhe lehen dy sy.

SHARMENTI DHE CEPI:

- Nese dega baze eshte e zhvilluar mire krasitet per te formuar trungun dhe sharmentin qe te perfundohet struktura e plote.
- Trugu dhe sharmenti = me shume ekuiliber dhe jetgjatesi (qarkullimi rregullt i linfes), trung i drejte (i rendesishem per mekanizimin), kthim i leht i sharmentit (sepse niset nga posht) dhe dege te balancuara pa prerje.
- Sharmenti duhet te jete gjithmone siper telit dhe asnjeher i perdredhur ne te.
- Nje trung i formuar me shume nyje nuk munde te japi nje rritje te balancuar.

ABC'ja KRASITJES DHE RRITJES



Ne fillim te vitit te trete munde te kemi 3 situata te ndryshme:

PLANI A: dege qe kalojne telin e fundit = formohet trangu + kapo kordoni me nje dege

PLANI B: dege mes telit baze dhe telit te fundit = krasitet 30 cm nga teli baze (formohet trangu)

PLANI C: dege poshte telit baze = lihen dy sy

Ne kete menyre bejme uniforme krasitjen per te thjeshtesuar menaxhimin e ardhshem.



Hardhija ndertohet gjithmone duke u nisur nga dega me e ulet. Ne kete menyre shmangim prerje qe pengojne qarkullimin e lufes = zhvillim harmonik i hardhise per jetgjatesine e saj.

KRASITJA GJELBERT NE VITIN E TRETE

Zgjedhja e degeve (te zhvilluara rreth 10-15 cm) per te:

- Balancuar rritjen e degeve sipas zhvillimit te hardhise
- Permiresuar prodhimin e pare
- Pregatitur pozicjonin korrekt te syve ne rinovim
- Shmangur nderhyrje me gershere qe lejn prerje te medha
- Shmangur qe deget e kota te harxhojne rezervat e trangu

GUNJO:

- Per rinovimin lihet nje dege me distance 30 cm poshte telit. Per te pasur pozicjonin e duhur te deges per frut ne vitin e ardhshem, per te qene me te sigurte munde te behen prerje vetem ne trangu e vitit te pare.
- Per prodhimin hiqen te gjitha deget ne kthese poshte rinovimit duke lene vetem pjesen horizontale nga 3 deri ne 5 sy, duke hequr te fundit (sipas largesise ne tel).

SHARMENTI DHE CEPI:

- Deget per 3-4 cepat e ardhshem duhet te jene te zhvilluara mire dhe te pozicionuara me distance te njellojte nga njeri tjetri, ndersa degat ne kthese duhen prere.
- Nese nuk kemi dege te mira, duhet lene nje dege poshte ktheses se poshtme per te prere sharmentin ne vitin e ardhshem.
- Dega pozicjonohet drejte pas ktheses (qe duhet te jete e lehte per te favorizuar qarkullimin e rregult te linfes).

Deget e frutave dhe sharmentat nuk duhet te jen shume te gjata sepse perndryshe nuk zhvillohen mire degat ne qender. Mes degeve dhe trupit lihen 10 cm distance per te shmangur qe degat e fundit te mos zhvillohen mire.



Ne fillim te vitit te trete me hardhi mjaft te zhvilluara (1) per formimin e cepave, zgjedhja degeve duhet bere shpejt:

- Fillimisht zgjidhen e para dhe e fundit, me pas ata te mesmet.
- Nese largesia eshte korrekte munde te presim degat e tjera ne kthese dhe gjat trupit (2).
- Vetem nese pozicjoni cepave te ardhshem nuk eshte korrekt, atehere lihet nje dege mjaft e ulet tek trangu per te formuar sharmentin vitin e ardhshem.
- Zakonishte kjo dege lihet gjithmone ne kete pozicjon (3) ne menyre te tille qe te kemi nje dege te pershtatshme per te formuar cepat e ardhshem, sepse nuk eshte prezence e kesaj dege qe pengon zhvillimin e degeve te qendres.

LIDHSET BIO

Per te shmangur mbledhje plastike vazhdimisht ne vresht per lidhjet, munde te perdorim alternativa te ndryshme, te cilat duhet ti pergjigjen tre kerkesave kryesore: jetegjatesia nder vite, elasticiteti dhe duhet te jene ekonomike.

Per lidhjet nje vjetore, nga kerkesa e limituar, eshte e thjeshte te gjejm lidhese bio, ndersa per lidhjet shume vjetore eshte me e veshtire ti gjejm.

Meqe lidhset naturale kan me pak elasticitet ne krahasim me lidhset e plastikes, per te shmangur nje shtrengim te drurit teper te forte, eshte me mire ta rrotullojme lidhsen dy tre here bosh para se ta lidhim.



Lidhset alternative, pervec plastikes:

1. Skoc lete (nuk shtrengon shume dhe eshte i mire per dy vitet e para)
2. Tel pet i veshur me leter (per te lidhur deget e frutit ne tel)
3. Litar (per trungun)
4. Pambuk (me diameter te mjaftueshem)
5. Leter me fije te presume

GUNJO'ja DHE SHARMENTI ME CEPIN

Vreshtaxhiu ka shpikur tre menyra krasitje: gunjo, ne forme peme dhe ne model terrace, ndersa mekaniku i ka transformuar ne sharmenta dhe cepa.

Nga plani fiziologjik problemet qe duhen zgjidhur spostohen ne planin praktik.

KRASITJA GJATE = gjatesia dhe kthesa ne degen e frutit


- Duke perdorur pjesen me prodhuese te hardhise munde te kemi nje prodhim me te madh dhe ndryshueshmeri ne zhvillim (duke pasur probleme ne krasitje).

KRASITJA SHKURTER = rritja dhe jetezgjatja e sharmentit

- Prezenca e drurit te vjeter mbledh shume rizerva por ka shume prerje.

GUNJO

- Ne pergjithsi kemi veshat me te gjate me kokrra me te medha.
- Problemi munde te jete numri i veshave dhe madhsija ndryshme e tyre.
- Per te reduktuar kapacitetin e ndryshueshmerise mes veshave, deget e frutit duhet te jene te shkurtra dhe duhen kthyer ne forme harku me pjesen me te larte te ktheses ne qender.
- Kemi prodhim vetem tek 4-5 syte ne qender qe jane te zhvilluar me pak.
- Duhet te presim degen e fundit dhe ate ne kthese poshte telit (jo ate rinovuese).
- Hiqen veshat nga dega e bazes.



Gunjo me kthese harku (me dy lidhje): pjesa e mesit (me e dobeta) eshte e stimuluar nga pozicjoni dominus (me e larta). Me krasitjen e gjelbert hiqen syte ne kthese dhe i fundit nese eshte teper i zhvilluar. Pervec atyre te qendres lihen nje ose dy sy ne lartesine e duhur per rinovim. Tek syte me te larte ne qender anulohet gjerarkija rritjes dhe shperndarja prodhimit eshte e rregullt = kemi me shume cilesi dhe sasi.

SHARMENTI dhe CEPI

- Problemi eshte vjettersija e hardhise.
- Veshat jane me te ngjeshur.
- Nder vite prodhimi ulet ndersa rritja shtohet.
- Ka nje avantazh me te madh per zhvillimin e degeve dhe te veshave.
- Per te mirembajtur hardhine nuk duhet te bejme prerje te shumta

Krasitja e shkurter i pershtatet shume krasitjes ne forme peme sepse duke mos percaktuar lartesis nuk eshte e detyrueshme te bejme krasitje tjera.



Edhe tek cepat rritja varet nga pozicjoni i syve. Gjatesija e cdo cepi duhet rregulluar ne varsi te rritjes se vitit te kaluar.



Problemi i "dritareve" (deget e dobeta ne qender) tipike i gunjove ka te bej edhe me sharmentat. Problem i cili zgjidhet duke lene me pak sy per hardhi.

CEPAT = ti lejme gjithmone te ulet do te thote ti shkurtojme jeten = ngritja e tyre eshte problem por jo sa tharja:

- Nuk duhen bere prerje per te ulur nje cep teper te gjate.
- Duhen mbajtur ashtu sic jane ose duhet pregatitur rinovimi i gjithe sharmentit duke filluar nga nje thithje e trungut.



Ne vend te krasitjes se zakonshme te cepit (2 dhe 4), eshte mire te besh prerje tek druri nje vjecar, duke rrespektuar bazen (1), prerja do te jete me e vogel dhe do te mbyllet shpejt (3) = do te kemi me pak rrezique ndaj semundjeve per drurin. Nyja e drurin dy vjecare do te thahet dhe munde te pritet ne krasitjen e ardhshme.



Me sharmentat dhe cepat nese fillojme keq (1) dhe perfundojme akoma me keq (4).



Tek druri vjeter duhet lene gjithmone nje vend i mjaftueshem nga prerja deri tek syu fundit (1) ose pasazhi i linfes per te mbajtur larg shenjen e prerjes nga nyja e thare (2).

KRASITJE DHE EKUILIBER



Kur kemi krasitje teper te pasura dhe sforcime ne rritje (1).

Me rritjen e paket mund te kemi vesha te vegjel dhe te rrall (cilesi e larte), me gunjo (2) dhe me sharmenta e cepa (3).



Duke ndryshuar numrin e syve per cdo hardhi kemi gjethe te balancuara dhe harmoni ne zhvillimin e degeve.



Hardhi e vjeter ne forme peme.

MENAXHIMI GJELBERIMIT

Cdo vit kemi nje moment kritik ku:

- Deget rriten shpejt
- Semundjet jane te paparishikueshme
- Klima jo gjithmone eshte e favorshme
- Puna me dore nuk mjafton asnjehere, kushton dhe eshte e veshtire per tu gjetur

Nese nuk organizojme mire shpenzimet e menaxhimit munde te rriten shume.

Duhet te gjejme zgjidhje per te:

- Shperndare punen
- Lehtesuar dhe reduktuar angazhimin

Sa me shume ta cojme vreshtin drejt veterregullimit vetvetiu aq me pak angazhim do te kete per menaxhimin e gjelberimit.

Me pak rritje dhe me nderhytje te menjehershme si zgjedhja degeve, mrojtja fidaneve, prerja degeve etj...

- Kemi me pak vegjetacion per te sistemuar/prere = me pak stres per hardhine.
- Nderhurjet e ardhshme jane me te vogla dhe me te thjeshta = me pak pune me dore.
- Hardhijat jane me pak te ndjeshme ndaj semundjeve = me pak trajtime
- Kostot e menaxhimit munde te ulen tepersisht.

Nuk eshte e vertete qe ne vreshtat bio kemi me shume nevoje per pune me dore, por edhe sikur te jete keshtu, jo gjithmone rriten cmimet sepse sigurohemi per mirembajtjen e vreshtit, fal te ciles eshte me e thjeshte te:

- Permiresojme nderhyrjet.
- Reduktojme shpenzimet (per blerjen e mjeteve teknike) dhe pasukseset (sidomos ne vitet e veshtira).

Nje vresht me impakt te ulet duhet te jete nje vresht me pak nevoja:

- Nje hardhi e ndertuar per prodhime te paketa duhet ti ket veshat afer rrenjeve (edhe pak cm bejne shume ndryshim).
- Lartesia e paket nga toka, pakson humbje lengjesh me transportin nga rrenjet tek deget.
- Favorizon nje klime te mire per pjekjen e rrushit

- Lartesia e paket shkurton ciklin vegjetativ

Per cdo hardhi kapacitetet e mbjelljes dhe te vetembrojtes jane te varura nga forma dhe nga madhsija e hardhise. Gjatesia e lastareve kondicionon kohezgjatjen e ciklit. Zakonishte gjatesija e tyre duhet te jete rreth 1 meter.

Kur largesija nga toka eshte pak, kemi:

1. Cilesi me te mire.
 2. Me shume rezistence ndaj klimes se thate.
 3. Me shume veshtiresi ne punet me dore.
 4. Mund ti paraqitet ngricave te pranveres.
- Duhet vendosur zgjidhja me e mire nga ata te sigurtat (1 dhe 2), te veshtirat (3) dhe te rrezikshmet (4).

NDERHYRJET NE GJELBERIM

- Menjehershmerija eshte e rendesishme per cilesine, shendetin dhe kostot.
- Ne fazen e pare te sezonit deget rriten shpejte.
- Nderhyrjet e vonshme i kushtojne shume kultivatorit te vreshtit (me shume pune me dore) dhe sa per hardhine (shenja te medha, harxhon shume energji dhe eshte me e ndjeshme ndaj streseve).
- Nje menaxhim i mire ndihmohet nga nje biondrydhim natyral dhe kuluror.
- Kerkon nje pune intense per vjeljen: vetem me pak rritje te degeve munde te kemi cilesi dhe kosto.



1. Mirembajtja korrekte e gjelberimit eshte menyra me e rendesishme per kontrollin e semundjeve.
2. Nderhyrjet e vonshme jane me te veshtira per kultivatorin, me rrezik me te madh ndaj parasitave dhe prerjet e shumeta e heqin me shume siperfaqe aktive hardhise.

Cdo gjethe harxhon me shume sesa prodhon deri ne momentin qe te arrij gjysmen e madhsise perfundimtare, ndersa nga ky moment prodhon me shume sesa harxhon. Ne cdo dege kemi gjethe me madhsi te ndryshme: kjo do te thote qe ne fazen e pare te zhvillimit, ndryshueshmerija e gjatesise se lastareve sjell ndryshueshmeri ndaj gjetheve te vogla dhe te medha, nje rritje vegjetative te ndryshme.



ZHVILLIMI UNIFORM I DEGEVE

- Duhet te shprehet ne fazat e para te zhvillimit.
- Kur zhvillimi i degeve nuk eshte uniform, deget qe rriten me perpara kane me shume avantazhe (sepse perdorin me perpara rizervat) dhe ulja e zhvillimit rritet (zejn vendin e disponueshem).
- Kur eshte e nevojshme duhen hequr gjethet e poshtme te degeve me te gjata per te pasur nje rritje me te avashet ne menyre te tille qe deget te rriten homogjenitet.
- Duhet te mesojme te bejme nje pune te perzgjedhur per cdo dege ne baze me rritjen e saj.

Duke pasur nje numer ekzakt degesh per hardhi aq me pak nevojte do te kete per nderhyrje.

HEQJA E GJETHEVE

Nderhyrjet para kohe per heqjen e gjetheve sherbejne per te favorizuar shendetin e rrushit dhe proceset e pjekjes.

- Veshat kane me shume ajrosje dhe njekohesishte jane te mbrojtur nga rrezet e djellit
- Heqja e gjetheve para kohe eshte e rendesishme per te reduktuar nevojen per pleherim duke pasur nje zhvillim vegjetativ me te avashet.



Heqja e gjetheve ne filimin e celjes (1) ose ne fillimin e lidhjes kokrrave ne veshul = veshat preken me mire nga trajtimet e pesticideve, dhe ne vjelje jane me te vegjel dhe me te rralle (2) me lekure me rezistente ndaj djellit = me shume shendet dhe cilesi. Gjate sezonit, zhvillimi vegjetacionit nuk pengon ajrosjen e veshave (3) por i mbron nga djegiet qe munde te prekin pjesen e larte (4) kur gjehet jane te vjetra.

- Duhet hequr vetem gjethet qe jane perpara, poshte dhe nepermjet veshave.
- Lehen gjethet siper veshave per ti mbrojtur nga rrezet direkte te djellit.

PRO: Veshat qe jane te ajrosur, te shendetshem dhe te rralle.

KUNDRA: Rrezik ndaj djegieve.

Nese duhet te lihen me shume gjethe, atehere do te hiqen ne fazen e pare te pjekjes.

	AKSIONI SHENDETSOR	AKSIONI FIZIOLOGJIK
PSE	Me shume ajrosje per veshat dhe me shume ndjeshmeri ndaj trajtimeve.	Me pak % lidhje kokrrash ne veshul dhe hardhi me te vogla.
KU	Zona me te prekura nga semundjet dhe heqja e gjetheve anash veshave.	Ndryshueshmeri e veshave, te medhenj dhe te ngjeshur, duhen hequr gjethet nga veshi me i larte deri tek i fundit.
KUR	Nga fillimi celjes deri tek fillimi lidhjes kokrrave ne veshul.	Nga deget e gjata rreth 20 cm deri ne fillim te celjes.

CIMATURA = prerja e degeve te gjata.

Me prerjen e degeve te gjata anulohet dominimi apiakal:

- Verja e feminelave sidomos tek sharmenat dhe cepat percakton nje ushqim te shumte per veshat te cilat do te jene me te ngjeshur me nje rrezik te larte kalbezimi.

Cimatura ka objektiva fiziologjik preciz:

- Rigjenerim i gjetheve.
- Me shume efikasitet fotosintetik ne periudhen e pjekjes.
- Mbledhje sheqeri.

Pak vite me pare, ky ka qene problemi me i rendesishem, por ne keto sezonat e fundit situata ka ndryshuar shume. Objektivat fiziologjik tani me nuk jane shume te rendesishem sepse mbledhja e sheqerit (energjiise) duhet paksuar, jo te rritet.

Nese nuk kontrollojme rritjen, prerja e degeve te gjata munde te behet e rrezikshme: e dhe semundjeve.

- Duhet per te mbajtur energjite afer veshit por duke vepruar ne kete menyre veshat do te jene me te medhenj dhe me ngjeshur, kshu qe shtohet perqindja e sheqerit.

Per hardhine "Cimatura" eshte njekohesisht nje traum dhe nje stimul:

- Dduhet te kete shenja tek prerja
- Duhet te mbeshtese zhvillimin e feminelave
- Pervet metabolizmit te zakonshem hardhija duhet te perballoje nje sforcim me te madhe = energjija e harxhuar mund ti shkaktojte deme hardhise, e cila munde te behet me e ndjeshme ndaj streseve dhe semundjeve.



- Per te kultivuar vesha te medhenj duhet te shmangim prerjen e degeve ose duhet ta vonojm, sepse sa me shpejt te presim deget aq me shpejt do te kete nevojte prerje tjeter
- "Cimatura" nuk duhet te behet vazhdimisht, vetem kushtu munde te arrihet nje ekuiliber. Neqoftese deget nuk priten nuk duhet te rrotullohen tek teli i fundit sepse krijohet nje hije e demshme. Deget me te gjata duhet te kthehen tek teli i fundit duke formuar nje hark.

Cimatura nuk duhet te behet kur rritja e degeve eshte e kontrolluar dhe deget nuk jane me te gjata se 1 meter: ky eshte nje objektiv i rendesishem qe duhet te arrijme kur nuk kemi shume rritje.

Mos prerja e degeve duhet te kete nje objektiv preciz:

- Vesha te rralle
- Permiresim i cilesise dhe shendetit
- Toka nuk duhet te jete e ngjeshur
- Me pak kosto
- Me pak trauma per hardhite
- Sidomos duhet te jete drejtimi per veterregullim

Vreshti eshte ideal kur nuk eshte e nevojshme heqja e gjetheve, prerja e degeve dhe rrallimi i veshave: me nje pune te rradhitur mire (toka/krasitja/gjelberimi) ky rezultat munde te arrihet shpesh.




Vreshta te ekuilibruara pa prerje degash.

Per te mos prere degat ne vresht eshte e nevojshme te permiresojme mjetet agronomike:

- Dendesia e mbjelljes
- Shartime jo te zhvilluara mire
- Krasitje e ekuilibruar
- Menjehershmeria e krasitjes se gjelbert ne fazen e pare

RRALLIMI I VESHAVE

- Nuk eshte rruga me e mire per te rritur cilesine
- Ka shpenzime te medha
- Nuk duhet te behet
- Jo gjithmone garanton perqendrim veshash
- Behet para vjeljes pa siguri ndaj klimes
- Eshte shume e rendesishme ne hardhite qe nuk jane te ekuilibruara
- Duke zvogeluar rritjen ulet nevoja per rrallim



Per shume lloje rrushi vonesa fenologjike e veshit te vogel qe del tek veshi madh shihet ne lulezim ndersa diferenca e pjekjes eshte me pak e dukshme (5/8 dit me vonese).

Dallohet gjithmone ndryshueshmeria e struktures se veshit.

Efektet e rrallimit ne llojet e vonshme me vesha te medhenj = eshte me i rendesishem veshi qe duhet te hiqet.

- Tek llojet e rrushit me vesha te medhenj eshte mire qe te hiqet veshi vogel qe del te bishti veshit te madh dhe majat sepse piqen vone. Ne kete menyre munde te kemi nje pjekje me te mire dhe me shume sasi.

“RRALLIMI”:

1. SHENDETESOR = ndarja e veshave
2. CILESOR = zvogelimi i veshit dhe rrallimi i tyre

1. PLANI = krasitja e thate, seleksionimi i degeve, heqja e gjetheve dhe prerja e degeve
2. SHERIMI = heqja e disa pjeseve te veshit ose heqja e gjithe veshit

RRALLIMI NE DY KOHE

Meqe klima gjate sezoneve eshte e paparashikueshme, eshte shume e veshtire te parashikosh sasinë e rrushit qe duhet rralluar, keshtu qe eshte e keshillueshme te ndajme sasinë e prodhimit ne dy kohe te ndryshme:

1. RRALLIMI SHENDETESOR (behet gjithmone i hershem)
2. RRALLIMI CILESOR (kur eshte e nevojshme ne mes te gushtit ose ne fillim te shtatorit per llojet e vonshme te rrushit)

Zakonisht ne vreshtat e balancuara rrallimi nuk eshte i domosdoshem, eshte i nevojshem vetem ne disa zona.

HARDHIJA NA FLET

Ngjyra dhe madhesia e gjetheve jane te rendesishme per rritjen e hardhise:

- Gjethe ngjyre jeshile te erret dhe te medha = shume rritje nga disponueshmeria e madhe e ujit dhe azotit
- Gjethe te vogla dhe te verdha = mungese uji dhe rrenjet nuk jane te zhvilluara mire

Dy anet e deges (gjethet baze dhe gjethet ne maje) jane pasqyra e mireqenjes ose e mosmireqenjes se hardhise (shfaqen simptomat e mungeses se ujit, ngjitja e paraziteve).


Ne rastin e mungeses se ujit, hardhija vuan.

Largesia ndermjet nyjeve te degeve duhet te jet e rregullt sipas karakteristikave te llojit:

- Nyje me te gjata = shpejtesi ne rritje
- Nyje me te shkurtra ose zig-zag = zhvillohet me veshtiresi

Temperatura gjetheve dhe e veshave kur eshte shume ngrohte fillon renja e gjetheve ne zona te ndryshme te vreshtit dhe jane shenja te rendesishme fiziologjike.

Ngadalsimi i rritjes vegetative eshte fillimi i fazes se grumbullimit qe vleresohet nga ngjyra = zverdhja e gjetheve eshte shenja e pare e tharjes.



Para se te zverdhen gjethet e poshtme, shenja e pare eshte stresi, epinastia dhe harja e gjetheve te majes.

PJEKJA E RRUSHIT

Lidhja mes sasise dhe cilesi eshte indirekte, kjo do te thote qe parashikimet munde te jene pozitive ose negative.

Cilesia perfundimtare e rrushit nuk eshte e lidhur ne menyre indirekte me sasine e prodhimit per cdo hardhi:

- Pjekja e parakohshme
- Klima gjat fazes se fundit te pjekjes

Kur rritja e degeve nuk eshte e balancuar, provokon fenomene te ndryshme dhe prish cilesine. Deget me te dobeta kane pak force ndersa ata shume te zhvilluara kane vesha shume te medhenj. Ne te dyja rastet pjekja eshte e vonshme.

- Diferenca e rritjes mes degeve te se njejtës hardhi vjen nga pozicioni i ndryshem i degeve
- Diferenca e rritjes mes degeve te hardhive te ndryshme varet nga ndryshueshmeria e rritjes se cepave ose ka te bej me karakteristikat gjenetike dhe shendetsore

REDUKTIMI MADHSISE SE HARDHISE DHE TE VESHIT

- Zvogelimi i volumit te hardhise rrit rraportin lekure/brume dhe rrit perqendrimin e sheqerit dhe te aciditetit.
- Me vesha me te vegjel kemi me pak prodhim per hardhi, me pak nevojë per rrallim dhe me shume uniformitet pjekje nga veshi ne vesh.

SI TE ULIM VOLUMIN DHE NGJESHMERINE E VESHAVE

Eshte me mire qe te kemi shume vesha te vegjel sesa pak vesha te medhenj. Per te permiresuar pjekjen duhet te bejme sa me shume rrallime dhe per te shmangur kalbezimin eshte e nevojshme te bejme nje seri nderhyrjesh te cilat varen nga se sa e rende eshte situata prezente.

- Jo pleherim per sidomos jo azot
- Perzirje vegjetale te veteprodhuara me shume C/N
- Bari duhet te pritet sa me vone te jet e mundur
- Vreshtat e zhvilluara = krasitje para se te bien gjethet (per te ndaluar marrjen e rezervave)
- Hardhi te balancuara = krasitje varfer
- Hardhi te zhvilluara = menjehershmeria e mirembajtjes se gjelberimit
- Krasitja gunjo
- Prerja e gjetheve te poshtme
- Mos prerja e degeve
- Mbrojtja antibiotritike
- Trajtime te gjetheve me kalcium dhe potas
- Nevoje per zolf ne pluhur

INVAIATURA = (ndryshimi ngjyres i kokrrave te rrushit)

NGA FILLIMI PERIUDHES "INVAIATURES" NUK DUHET TE KETE ME RRITJE TE MAJAVE TE DEGEVE

Rritja e vegjetacionit pas periudhes kur kokrrat ndryshojne ngjyre shkakton:

- Vonese ne pjekje.
- Me shume ndjeshmeri ndaj klimes se thate dhe ndaj semundjeve.



Ne te njejten dege nuk munde te bashkejetojne faza fenologjike te ndryshme. Ne foto dallohet qarte pjekja e rrushit e:

1. Hardhive te rritura ... (ne toke te punuar)
2. Hardhive ne ekuiliber ... (qe punojne vetem per mbledhjen ne vesh)

VONESE NE PJEKJE


- Invaiaura e vonuar per shkak te rritjes se tepert
- Renje shiu ne fazen e pjekjes = rritet volumi kokrrave te rrushit

Lekura eshte nje membrane mbrojtese = uji leviz sipas lageshtires:

- Lageshtire te ulet ne ambjent dhe temperatura te larta = uji kalon nga brenda jashte, kokrra e rrushit humb ujin per shkak te thithjes se ajrit.
- Lageshtire te larte ne ambjent dhe temperatura te uleta = kokrra rrushit hidratohet duke thithur uje nepermjet lekures.

I njeiti fenomen ndodh edhe me gjethet:

- Ne rastin e mungeses se ujit = gjethet qe te mos thahen thithin uje nga veshi, i cili fillon te vyshket.
- Ne rast renje shirash = gjethet hidratohen dhe furnizojne veshin me uje.



DINAMIKAT E PJEKJES

Pjekja e rrushit karakterizohet ne dy raste:

- Nga niveli brumit: sheqeri dhe acidi = prodhohen nga gjethet dhe transportohen tek brumi kokrrës së rrushit.
- Nga niveli lekures: ngjyra, aroma dhe parfumi = prodhohen nga lekura.

Kjo shpjegon arsyen pse dy pjekjet nuk korrispondojne me njera tjetren.

Nenvizojme: substancat e pasura mblidhen tek lekura ndersa nje pjese e acideve mblidhet tek brumi i kokrrës.

Gjetesia e deges dhe pjekja e rrushit:

- Tharja e drurit dhe pjekja e veshit jane dy faza te lidhura me njera tjetren.
- Pjekja eshte e mire kur dega ndalon rritjen e saj.
- Veshat ushqehen sidomos nga gjethet.

Pjekja e plote (sidomos per disa lloje rrushi):

- Vetem nese rrushi eshte i shendetshem lejon vonimin e vjeljes deri ne castin ideal.
- Shume veshtiresi ne pjekje varen nga problemet e lindura ne muajt e meparshem qe duhet te zgjidhen ne castin e duhur.

FIZIOLOGJIA E PJEKJES

Proceset fiziologjike qe sjellin pjekjen e rrushit jo gjithmone jane te lidhura me njera tjetren por varen nga: efikasiteti fotosintetik, madhsija e veshit, sasia e rrushit dhe ndryshueshmeria e klimes.

PARAMETRAT	VAREN NGA
SHEQERI	Fotisistesa dhe rregullimi rezervave
ACID "TARTARIK"	Shiu dhe rritja e kokrrave
ACID "MALIK"	Temperatura verore dhe ushqim potasi
SUBSTANCA FENOlike DHE AROMATIKE	Ndririm dhe ndryshueshmeri termike
ELEMENTE MINERALE	Natyra e tokave dhe disponueshmeria e ujit

Tek rrushi sheqeri dhe ngjyra nuk varen nga njera tjetra

- Pak sheqer = pak ngjyre
- Shume sheqer = jo gjithmone shume ngjyre

Zakonisht aciditeti rrushit shtohet me rritjen dhe me hijen e veshit. Me nje perqindje te larte sheqeri dhe njekohesisht me nje aciditet te larte mund te kemi nje intensitet fotosintetik dhe nje pjekje te parakohshme qe pengon degradimin e acidit malik.

Edhe me mungese uji mund te kemi nje perqindje te larte sheqeri bashke me aciditetin.

Vite te ngrohta dhe te thata = me pak acid malik

Vite te fohta dhe me shi = me pak acid tartarik

- Vite te ngrohta dhe te thata = temperaturat rriten shpejt ndersa permbajtja e polifenolit eshte e ulet per shkak te temperaturave te larta

gjat nates: do te kemi nje pjekje te mire fenolike me perqindje sheqeri vetem nese kushtet e rrushit lejojn qe te presim me shume ndryshueshmeri te klimes dite/nate.

- Vite te ftohta dhe me lageshtire = nje pjekje fenolike e pranueshme munde te meret vetem me pak prodhim: nje pjekje e mire duhet te kete pak perqindje sheqeri

PJEKJA FENOLIK DHE PJEKJA PELIKOLARE

POLIFENOLI

SASIA	➤ faktoret gjenetike dhe te kultivimit
CILESIA	➤ gjenotipi
EKSTAIBILITETI	➤ niveli pjekurise (klima, prodhimi per cdo cep) dhe gjenotipi

	LEKURAT	FARAT
RRUSHI I PJEKUR	I pasur me "antociani" dhe me "tannini inaktiv"	Te varfera me "tannini polimerizati"
RRUSHI I PAPJEKUR	Te varfera me "antociani" dhe me "tannini reaktiv"	Te pasura me "tannini" pak te "polimerizuar" dhe shume reaktiv

KLIMA DHE PJEKJA

Sado e keqe te jete klima gjat muajve te pare (ne te cilet percaktohet sasia e prodhimit) ,cilesia e prodhimit te vitit varet nga klima e periudhes se fundit te pjekjes (sidomos 10-15 ditet e fundit). Ne fazen e fundit mund te mblidhen 15 deri ne 20 gram sheqer ne nje jave por percaktohet sidomos nga pjekja e lekures. Ndryshueshmeria e temperaturave dite/nate ne fazen para vjeljes eshte e domosdoshme per substancat e pasuar te lekures dhe per shendetin e rrushit (me pak kalbezim). Eskursion termik ngadalson pjekjen duke e bere te plote, te ekuilibruar dhe homogjene.

Temperaturat e larta gjate nates ne fazen e pjekjes ulin sasine e polifenolit dhe te aromes (sheqeri prodhuar nga fotosintesa gjat dites konsumohet nga rritja vegjetative).

Edhe temperaturat e uleta gjat nates nuk jane te favorshme per substancat e pasura. Per llojet e rrushit te vonshem ne fazen e pjekes temperaturat ideale jane rreth 22-24°C gjate dites dhe 10-12°C gjate nates pa lageshtire.

FAZA E VJELJES

Kontrollimi i pjekjes se rrushit nepermjet analizave sensoriale eshte shume e rendesishme per te vendosur ditën e fillimit te vjeljes. Me monitorazhin ne vresht munde te percaktojme:

- Karakteristikat gjenetike te rrushit.
- Gjyra dhe butesia e kokrrave.
- Ngjyra e lengut qe leshojne lekurat kur ferkohen me njera tjetren.
- Ndarja e brumit nga lekura dhe farat.
- Pamja e plote e veshit.

Ndryshueshmeria e pjekjes zakonisht varet nga ndryshueshmeria e brumit me lekuren. Ne te njejtat lloje rrushi me veshja te medhenj ndryshueshmeria e pjekjes eshte shpesh mes kokrrave te te njejtit vesh e jo te veshave te ndryshem. Kur te arrihet nje nivel pjekje mund te percaktohet data e vjeljes duke paramenduar sesa dit djell nevojiten per pjekjen e plote.

Ne vitet e veshtira data e vjeljes duhet te percaktohet ne baze te pjekjes dhe te rrezikut per humbjen e prodhimit.

Zakonisht nuk duhet te nxitohemi per te filluar vjeljen por nderkohe duhet te informohemi per klimen e ardhshme dhe duhet te pregatitemi qe vjelja te jete sa me e shpejte nga zona ne zone.

KARAKTERISTIKAT E NEVOJSHME PER PJEKJEN

- LEKURA: ngjyre e forte, pak rezistuese ndaj percapjes, aroma te ndryshme.
- BRUMI: duhet te ndahet mire nga lekure, arome frutash dhe ngjyre e kyqe.
- FARAT: ngjyre kafe te erret

PJEKJA AROMATIKE = aromat kryesore jane te perqendruara tek lekura ndersa pjekuria varet nga klima.

Data e fillimit nuk percaktohet nga substancat aromatike sepse ata mblidhen para se te kemi nje perqindje te mire.

VRESHTARIA DHE NDRYSHUESHMERIA E KLIMES

Ne keto vitet e fundit nxehja globale ka qene shkaku me i rendesishem i humbjes se cilesise dhe te sasise te shume vreshtave. Te gjithë e dime se kunder natyres nuk mund te fitojme, qe te vazhdojme te jemi optimist duhet te mundohemi ta shohim cdo problem si ne nje menyre per tu permiresuar.

Nese klima ndryshon duhet te nryshojme edhe menyren e kultivimit te rrushit. Te ndryshojme menyren do te thote te provojme gjera te reja, te ndryshme dhe pse te cuditshme ne menyre qe te kemi njekohesisht cilesi toke duke respektuar shpenzimet dhe pamjen e ambjentit.

"Nuk mund te bejme nje hap perpara dhe dy mbrapa: te besh gjene e duhur nuk eshte gjithmone e thjeshte dhe e thjeshta nuk eshte gjithmone gjeja e duhur, kshu qe duhet te thjeshtesojme te duhuren dhe jo te bejme te duhur te thjeshten."

Problemi qendror eshte mungesa e ujit por para se te mendojme per vaditjen duhet te bejme te pamunduren per te permiresuar disponueshmerine e ujit. Reshjet e shiut jane gjithmone me te rralla dhe me te rrezikshme keshtu qe duhet te percaktojme strategji per te mbrojtur token nga erozioni dhe per mirembajtjen e strukture.

Edhe pa vaditjen mund te permiresojme shume menaxhimin agronomik per te rritur hyrjet dhe per te reduktuar daljet.

1. Nga niveli tokes
2. Nga niveli hardhise


TE PERMIRETOSH VADITJEN

	TOKA	HARDHIA
ME SHUME HYRJE	>Infiltrim <erozion	>dendesia dhe thellesia e rrenjeve
ME PAK DALJE	<avullim >thithja e ujit	<avullim >tranpirim

Te rrisesh sasine e ujit qe hyn ne toke dhe kapaciteti per ta mabjtur.

Te rrisesh kapacitatin e thithjes se rrenjeve ul konsumin e ujit te hardhise.





FAZAT E PUNES SE ARDHSHME:

- a. Heqja e gjetheve i nyjeve te para
- b. Drejtimi i degeve
- c. Mos prerje degash

Pas heqjes se gjetheve ndihmon shume per te mos prere degat. Ne kete menyre kemi:

- Maj/qershor = periudhat me te rrezikshme per parazit = veshat jane te ajrosur mire.
- Korrik/gusht = periudha me rrezik djegie = veshat jane gjithmone te ajrosur dhe gjelberimi eshte ne renje

MOSHA E VRESHTIT

Shkaqet e para te prishjes se vreshtit jane traktorat (ngjeshja e tokes) dhe gershera (rrjdhja e linfes). Vreshtat e vjeter jane me te rezistueshem dhe kane me pak probleme ne vitet e veshtira = eshte e nevojshme te vjetersojme vreshtin sepse jep vere me te mire, ka me pak rrezik dhe me pak kosto.

- Te paksojme kalimet me traktor

- Te shmangim shenja te theksuara afer qarkullimit te linfes

KULTIVAR

Ne vitet me te veshtira eshte e vazhdueshme te shohim rezistencen e ketyre llojeve rrushi qe kan pranuar ne kohe procesin lokal me te pershtatshem per shume shekuj tek cilat kane edhe nje peshe te madhe edhe ndryshimet e klimes.

KRASITJA

Sharmenta ne pjesen me te madhe te drurit te vjeter ne teori duhet te garantoje nje rezistence me te madhe por kjo nuk eshte gjithmone e sakte: qe sigurisht ben diferencen nga krasitja dhe rritja e rregullt.

DENDESIA E MBJELLJES

Ne vreshtat ku hardhite jan me afer njera tjetres kemi me shume nevoje per hapesire dhe per elemente ushqyese duke stimuluar veterregullimin qe favorizon shtrirjen e rrenjeve ne thellesi dhe rrit rraportin rrenje/gjethet per hardhi = rrenjet thithin me shume dhe gjethet harxhojne me pak.

ESPOZIMET

Ne sezonat e fundit ngrohja globale ka shkaktuar jo pak surpriza (pozitive dhe negative). Ne shume raste kan pasur avantazh pozicionet qe historikisht nuk kane qene shume te favorshme, ndersa ata me te favorshme kane vuajtur me shume. Kjo nuk duhet te sjell konkluzione te parakohshme dhe te mohojme ate qe eshte bere nder vite por kerkon nje analizim te kujdesshem.

ASPEKTET PATOLOGJIKE

Ndryshimet klimatike do te ndikojne ne sekesionimin e paktogjeneve dhe te fitofaxhit. Disa nga te cilat do te jene me shume te favorizuara ne krahasim me te tjerat. Me siguri vreshti do te shpetoje por nuk do te jete per shkak te ketij apo atij produkti te mrekullueshem por me njohuri te madhe te epidemiologjise se parazitve (cikli vital dhe infektiv) dhe sidomos me nje strategji korrekte te mbrojtjes ne nivel te tokes (qe nuk eshte nje vresht por shume vreshta afer njeri tjetrit dhe ambjenti qe i rrethon.

Sidomos per parazitet e rinj do te jete i vendosur monitoraxhi dhe kontrolli i zjarreve ne kompresor:

- Nuk mjafton te nderhysh vetem tek vreshti yne meqe parazitet nga te cilet duhet te mbrohemi nuk e bejne
- Duhet te mesojme te organizojme nje luft ne nivel te kompesorit = menyra e vetme qe munde te garantoje me shume efikasitet

Vetem kështu vreshti i komshiut nuk do të jetë rrezik (i infektimit dhe ndotjes) por do të jetë mbrojtje.

Natyrisht duhet të bazohet në teknika agronomike të përshtatshme për të aprovuar një ekuilibër të zhvillimit vegjetativ dhe produktiv, dhe nuk duhet të priset nga përdorimi i helmeve kimike ose nga presioni i natyrës jo agronomike.

MROJTJA

Cdo harshi është një ekosistem në cilin jetojnë shumë insekte, vegjetale dhe mikro-organizma që jetojnë sipër ose afër si në gjethe, në vështa dhe në rrenje. Të gjithë organizmat kanë një rol të veçantë që në drejtim të hardhise mund të jenë pozitive, negative ose indiferente. Por ajo që ka rëndësi është prezenca e gjithsecilit duke jetuar në të njëjtin ambient vepron me atë të tjerave. Gjithçka është e lidhur dhe mund të funksionojë mirë në raport reciprok. Si për token dhe për vegjetacionin një ambient i pasur me biodiversitet është një rezervë shumë e rëndësishme e "aleatve dhe të sentinelave", të domosdoshme për vetëmbrojtjen e hardhise. Ja pse vreshtaxhiut nuk i konvenon të thuhet këto gjëra të lidhura me njëra tjetrën.

Kur flitet për mbrojtjen e hardhive në përgjithësi duhet të shqetësohemi se çfarë duhet të përdorim kundër këtij apo atij lloji sëmundjeje. Edhe në vend të helmeve kimike përdorim rreze dhe xolof dhe pse kerokojmë të eliminojmë duke i zëvendësuar me elemente natyrore. Në parim nuk ndryshon deri sa të korigjojme mënyrën tonë të bërit dhe të menduarit. Zhvillimi i një sëmundjeje është rezultati i dy anëve: sëmundja dhe faktori që e shkakton. Duhet të punojmë me të dyja. Në mënyrë gjithmone si të luftojmë kerpudhat dhe insektet por duhet të dimë shumë mundësi për të rritur rezistencën e hardhive. Pas mbështetjes dhe limitit natyral dhe një menaxhim agronomik të mirë mund të mbështetemi edhe në mundësi për të përdorur substanca me aksione fitofortifikuese në vend të fitofarmakeve. Principi aktiv që jep rezistencë janë parë me kohë, por kohët e fundit janë verifikuar formula të reja dhe shumë interesante.

MBROJTJA

Mund ta përcaktojmë në dy nivele:

1. Indirekte = për të stimuluar rezistencën e hardhive
2. Direkte = kundër agresivitetit të sëmundjeve

Në përgjithësi kalojmë direkt në fazën 2. Kurse në vreshtat bio faza 1 që paraqet punën e zakonshme ndërsa faza 2 paraqet punën e jashtëzakonshme.

BIO: NGA OBJEKTIVI NE MJETE


Kur fillojme te bejme vreshtari bio objektivi eshte te mos perdorim helme kimike. Kjo ishte perqendruar ne aspektin ekologjik per te permiresuar perdorimin e ramit dhe zolfit. Duke punuar ne kete menyre prodhohej vere qe ishte bio por jogjithmone e mire. Ne kohe u kuptua se objektivi dhe cilesia globale meqe bio eshte menyra me inteligjente dhe e sigurte per ta pasur. Prandaj tani prodhohen verera me cilesi dhe per me teper jane edhe bio.

ATY KU NUK MUND TE BEHET BIO NUK MUND TE KEMI CILESI

Shendeti eshte ne vend te pare per te pasur cilesine. Asnje fitofarmak nuk ben mrekulli, qe te garantoje maksimumin e kushteve agronomike. Vrulli i semundjeve nuk mund te zgjidhet duke bere nje program fitoiatrik me intens.

Aty ku kushtet e ambientit percaktojne nje presion te semundjeve per te mbrojtur rrushin, te shendeshem duhen bere gjithmone trajtime kimike = zona nuk eshte e pershtatshme per kultivim.

- Ndotja jo vetem qe ben keq por edhe kushton dhe nuk na konvenon. Bio eshte vendimtare per zhvillimin e vreshtarise.



Semundja mund te zhvillohet nga 0 ne 100.

Masat e mbrojtjes mund te behen ne tre nivele:

1. LUFTA DIREKTE	AGRONOMIKE	JO	MENAXHIMI KOLTURES PER TE BERE CILESI NE MENYRE NATYRALE
---------------------	------------	----	---

2. TRAJTIME ME PRODUKTE QE KANE REZISTENCE	LUFTA E VAZHDUESHME NDAJ PARAZITEVE
3. TRAJTIME ME PRODUKTE NATYRALE ME AKSION DIREKT	NDERHYRJE TE JASHTZAKONSHME VETEM NE KUSHTE TE VECANTA

Tani per tani eksperimentet e kompanive te bera pa rame dhe zolf tregojne qarte mundesine per te kontrolluar semundjet (pernospora dhe oidio). Ne disa raste jane arritur rezultate te mira edhe ne kushte te veshtira. Por duhet akoma te kuptojme limitet dhe rezultatet me te mira. Sigurisht per te mos krijuar varesi nga zolfi dhe rame duhen konsideruar menytrat per te perdorur vetem kur te rregullohen burimet natyrale te vreshtave, qe jane baza per nje vreshtari me te mire. Mundesia e vetembrojtjes varet nga niveli veterregullimit vetvetiu.

- Ne perqindjen e caktuar si vetembrojte eshte gjith puna e bere me token dhe me hardhite.

PROTOKOLLI BIO

- Asnje interes per hibridet rezistente
- Menytrat agronomike
- Rritja e rezistences

Vreshtaria qe nuk behet = duke punuar tek shkaqet dhe jo tek efektet:

- Ne hardhite (me zhvillim te dobet) = funksionon mire kunder semundjeve
- Ne vresht (mbjellja e barit) = funksionon mire ndaj insekteve
- Ne monitorazh = funksionon mire ndaj semundjeve sistematike

FITOIATRIA

Historikisht eshte zhvilluar ne 3 nivele:

1. Kura = fillimisht u mendua te gjendej nje fotofarmak qe te bej efekt ne menyre korrekte
2. Parandalimi = me pas u kuptua nevoja aktuale dhe praktike per te trashur hardhite
3. Menaxhimi i territorit = ky eshte hapi vendimtare qe duhet bere akoma

BIONDRYSHIMI

Semundjet si, peronospora, oidio, tinjole dhe ranjeti, jane cdonjera nga shume problemet qe hasin kultivatoret dhe qe nuk duhen luftuar nje nga nje por te gjitha bashke.

Rruga me emire dhe me e sigurte bazohet ne punen per te ulur ndjeshmerine e vreshtit dhe vrullin e semundjeve. Praktikrat e mira agronomike rrisin vetemrojtjen dhe favorizojne nje biondryshim te cdo niveli:

- Ato qe funksionojne mire jane te populluara nga shume lloje dhe cdonjera ka nje numer te kontrolluar nje nga nje.
- Ato qe funksionojne kan shume individe dhe pak lloje

Ne vendet e pasura biologjike (si ne nivel te tokes ashtu edhe te gjelberimit) mikro-organizmat ndihmojne hardhite te ushqehen dhe te rriten me rregull. Ne keto raste rraporto mes hardhise dhe parazitit nuk eshte direkte por mesatare nga prezenca e shume "setinele". Ne ambientet e vreshtarise biondryshimi ndihmon peisazhin.

Biondryshim = ne vreshtari do te thote >zenja e hapesirave te preferuara nga semundjet.

Ne vresht njellojshmeria zevendeson biondryshimin natyral. Njellojshmeria thjeshteson ne maksimum raportin parazit/semundje. Nje toke e punuar eshte e pabanuar dhe trajtimet sterilizojne ambjentin. Nga njera ane dinamika ekologjike e njellojshmeria eshte vetevrasje.

Vreshti, ne planin ekologjik, eshte shume i dobet:

- Nje hardhi e kultivuar terheq te gjithe parazitet per te luftuar me fitofarci jo selektiv
- Gjerat rregullohen vetem nese rritet numri i limitatorve natyral dhe qe perdoren principe aktive toleruse ndaj insekteve, kerpudhave dhe baktereve.

Biondryshimi ka nje vlere jo vetem ndaj peisazhit por edhe funksionale: ekologjia meson qe nje sistem agronomik me i pasur me biondryshimin eshte me e qendrushme.

BARI MBRON VRESHTIN

Ne nje toke te punuar, pjelloria biologjike eshte e ulet, ndersa bari i jep jete ambjentit:

- Ne nivel ajror
- Ne nivel te rrenjeve

Prezenca e mbulimit me bare bashkon jeten e nendheshme me ate siper tokes per raportin direkt-indirekt (me nje mundesi te mire per hardhite e kultivuara.

SISTEMI AGRONOMIK I VRESHTIT

Ne brendesi te sistemit agronomik eshte nje ekosistem i lidhur me teknikat kulturore = kur e ben te funksjonoje eshte ne te mire te kultivatorit:

- Vreshtat jan te banuar nga nje shumice mikro-organizmash si ne nivel ajror ashtu dhe ne ate te rrenjeve qe veprojne mes tyre dhe me hardhite.
- Mireqenja e hardhive varet nga ekuilibri mes te mirave dhe te keqijave = nese vlejn te parat kemi nje rritje te rregullt, ne rast te kundert kemi nje rritje te semundjeve.

Ne raportin mes tokes dhe rrenjes nje rrol te rendesishem ka mikro-flora e terrenit (baktere, kerpudha etj..) qe jetone ne rrenje dhe rreth saj: rrenja e zhveshur eshte shume e dobet.

Si ne gjethe, ashtu dhe ne vesha, presenca me shumice e mikro-flores luan nje rrol te rendesishem per mbrojtjen natyrale kunder semundjeve.

Hardhite ne stadin e eger japin nje perqindje shume te lart mes llojeve:

- Shendeti mes tolerances dhe stresit.
- Semundja, vuajtja (si nje menyre e veterregullimit selektiv).

Hardhite e kultivuara mund te japin nje pjese te limituar mes llojeve. Shendeti artificial dhe rreziku i semundjeve. Kjo ndodh kur kultivimi ndodh kur kultivimi behet me metoda intensive. Objektivi i kultivimit natyral eshte te sjellim shfaqjen e rezistences ne hardhi = eshte nje objektiv impenjativ ku cdo detaj ka shume rendesi.

LUFTA KUNDER KALBEZIMIT

Lufta me botrite kunder kalbezimit acid na meson te kurojme shkaqet dhe jo efektet.

Meqe eshte nje molokule natyrale atkive duhet ta parandalojme me menyre agronomike. Ne disa zona jan parashikuar trajtime specifike.

Ndjeshmeria me botrite e kalbezimit acid

- Shenjat qe shihen = vesha te ngjeshur dhe lekura e holle

- Shkaku kryesor eshte (klima me lageshtire ne fazen e pjekjes).

PARANDALIMI AGRONOMIK NDAJ KALBEZIMIT

- Inerbimentet ne fazen e pjekjes "filtron" me pak ndryshueshmeri ujore dhe ushqyese = me pak rritje veshash dhe kokrra me te vogla
- Pleherimi = asnje ose sa me pak, jo azot jo potasio ose kalcium (trajtime ne gjethe ose ne disa pjese te gjetheve)
- Punimet ne gjelberim = drejtimi i shpejte dhe preciz i degeve, pa prekur veshat, telat te tendosura mire, heqja e gjetheve ne fazen e rritjes dhe te pjekjes se veshave.
- Krasitja = heqja e degeve ne kthese te hardhise, sharmenta shume te zhvilluar (vesha me te medhenj dhe te ngjeshur). Krasitja ne dy kohe, gunjo (vesha me te rrall dhe me pak gjelberim)
- Rregullimi i drejtimit te rreshtave = favorizon ajrosje dhe mirembajtjen e drenazhit ne shtyllen kryesore.

Per te zvogeluar ngjeshmerine e veshave dhe te kokrrave duhet te fillojme nga:

- Forca e rritjes = te shmangim deget qe zhvillohen shume.
- Para celjes = heqje gjethesh te parakohshme per te ulur shpejtesine e rritjes se kokrras (esha te rralle dhe lekure me e trashe).

LUFTA ANTIBOTRIKE DIREKTE

- Per shendetin fizik = per te trashur lekuren (bentonite, litotamnio, mjell shkambi...ne kohen e ndryshimit te ngjyres se kokrras) ose per ti mbajtur me te thata (bentonite ne fazen e fundit te pjekjes).
- Per anen mikrobiologjike (b. subtilis, b. likeniformis, trokoderma spp.) = dhe kunder paraziteve

Shenime per produktet mukrobiologjike dhe antibiotrike

Ne baze te Bacillus subtilus, Bacillis likeniformis ose trikoderma spp (B substilis ka edhe nje efekt antisodik qe mund te sherbeje ne strategjine e kombinuar me Aq pa zolf) doza varet nga formula per shperndarjen parashikohet nje perqendrim i vogel ideal. Sperkatja behet ne te dyja anet e rreshtit, ne pjesen e veshave duke i lagur mjaftueshem (200 l/ha):

- Sperkatje parandaluese
- Zonat me lageshtire = para mbylljes se veshit dhe ndryshimit te ngjyres.
- Zona te ngrohta = ndryshimi i ngjyres
- Gjate pjekjes = rritja e dozës sipas shirave
- Sperkatje menjeher mbas shiut

- Sperkatje para shiut duke shtuar nje doze natyrale

ESKA

Eshte nje semundje e karakterizuar nga shume kerpudha:

- Infeksioni vjen nepermjet prerjeve (nga krasitja)
- Nepermjet gershereve por perqindja eshte e ulet
- Disa nga shkaqet jane era dhe shiu
- Ne shume raste jan numeruar edhe 150 hardhi te thara ne vit

Profilasia eshte:

- Mbrojtja e prerjeve te krasitjes me cera, propoli dhe trikoderma, por nuk mjafton
- Prerjet duhet te behen sa me te vogla
- Eshte mire qe prerjet te behen ne drurin e ri (1 vit)
- Prerja duhet te behet sa me larg nga dega e lene
- Krasitja duhet te behet sa me vone = kur prerjet behen ne dhjetor duhen 3 muaj qe prerja te mbyllet, ndersa prerja ne mars duhet 1 muaj (sipas klimes gjate vitit)
- Ne krasitjen e zakonshme nuk duhet te perdoret ne asnje menyre sharra (perdoret vetem kur pritet hardhia per tu ripreteritur), prerja behet 20 cm nga toka
- Krasitja duhet bere sipas fazes se henes dhe jo pas periudhes se shirave (sepse zhvillohen kerpudhat dhe eskat)
- Krasitja nuk duhet te behet ne periudha te ftohta
- Krasitja duhet te behet ne kohe te ndryshme me heqjen e degave (per te bere prerjet ne kohen e duhur)
- Te zgjedhim kohen per krasitje duke i dhene prioritet vreshtave te rinj qe nuk jan te infektuar
- Te heqim para veres te gjitha hardhite e prekura
- Te mos leme copa te hardhive te prekura ne vresht
- Ne vreshtat e semura nuk duhet te grijme deget ne toke
- Pas krasitjes duhet te heqim deget nga vreshti



1. Prerjet e medhaja cojne hardhine ne tharje
2. Tharja e hardhise
3. Sinptoma kronike ne vreshtat 3 vjecar
4. Duhet te tentojme te rikuperojme hardhite e prekura

FITOPLAZMAT

Nxirja e drurit dhe zverdhia e hardhise.


- Fitoplazma jeton vetem ne pjesen ne jete te hardhise.
- Gjate stineve fitoplazma eshte ne gjethe dhe vesha.
- Para renjes se gjetheve fitoplazma kthehet ne trup dhe rrenje.
- Duke hequr deget e prekura sa te shihen shenjat e para gjate zhvillimit te gjelberimit ka me shume mundesi te eliminojm fitoplazmen nga hardhia per ta bere te shendetshme.
- Kur hardhia rregullohet vete eshte nje fenomen natyral qe behet sipas llojit dhe ambjentit.
- Hardhite e prekura nga zverdhia jane me te ndjeshme nga semundjet sistematike.



1. Skuqje te dukshme mes damarve ne rrushin e kuq
- 2 Dege te buta qe bien shpejt
- 3 Njolla te zeza dhe tharja e veshit
- 4 deget nuk lidhin vesha
- 5 Eska dhe zverdhie ne te njejten hardhi



1. Heqja e degeve me keto sinptoma
2. Krasitje e jashtzakonshem (shkurtim i trungut ne vere)




Ne nje vresht me "sangiovese" te prekur shume nga nxirja e drurit kan qe 796 hardhi ne fund te gushtit: nga keto 697 (87%) jan pa simptoma ne dy sezonat e ardhshme.


SHENJAT E DISA SEMUNDJEVE




1. Njolla ne trupin e degeve
2. Peronospora larvata (tipike ne fillim te veres)
3. Eskoriozi (pjesete e prekura eliminohen)
4. Black rot (e rralle dhe shume e rrezikshme)




1. Cerdhe ne gjelberim (faza e pare)
2. Veza me koke te zeze gati per te dale
3. Plasja e kokrres favorizon prishjen e acidit te kokrres
4. Merimanga e verdhe
5. Shpime te qarta ne qender (njolla te verdha, skuqje ansore te gjetheve dhe njolla te gjelberta)
6. Kocinilie (ne zonat e ngrohta por perhapet edhe ne zonat e tjera)



1. Erinosi (shihet shpesh por nuk eshte e rrezikshme)
2. Eutiposi (hiqen menjehere hardhute e prekura)
3. Skuqje ne qaf te larvave
4. Zigena (ne deget ansore me pak por ne vitet e fundit po shperndahet shume)
5. Zigena ne vere (duke lokalizuar shperndarjen mund te parandalojme ate te pranveres se ardhshme)



1. Mungesa e potasit (ndryshimi i ngjyres ne gjethet e poshtme)
2. Nxirje (mungese e forte e potasit ne fazen e pjekjes)
3. Mungesa e magnezit (nga gjethet e poshtme ne lloje rrushi me gjethe roze)
4. Mungesa e magnezit ne llojin e bardhe



1. Mungesa e "boro" (zverdhia e gjetheve dhe tharja e dredharaku)
2. Mungesa e "boro" (plasja e kokrrave)
3. Klorozi ferrika (zverdhia e gjetheve, jo e damareve)
4. Klorozi ferrika (zverdhia e gjetheve te majes)

